Seanca Plenare
29/07/2022

KUVENDI
NR 2685 DATE 29.07.'22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr._____ prot. Tiranë, më ___/___/ 2022

Lënda: **Depozitim projektligji.**

Drejtuar: **Znj. Lindita NIKOLLA**

Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

E nderuar Znj. Kryetare,

Bazuar në nenin 81 pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 68, të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqesim projekligjin **"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 " Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar".**

Ju faleminderit,

DEPUTETËT PROPOZUES

1. Taulant Balla

2. Klotilde Bushka

P R O J E K T L I G J

Nr. _____/2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10019, DATË 29.12.2008, "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, nenit 81, pika 1, dhe nenit 83, pika 1 të Kushtetutës, me nisëm deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 63, pika 3, ndryshohet si më poshtë:

"Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës, për të cilin përfundon me sukses procesi i verifikimit të pastërtisë së figurës, dhe që regjistrohet si kandidat për deputet, si kandidat për kryetar bashkie ose për këshillat vendor në organet përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve".

Neni 2

Pas nenit 63, shtohet neni 63/1 me këtë përmbajtje:

Neni 63/1
"Procesi i verifikimit të pastërtisë së figurës"

1. Subjekti zgjedhor, 70 ditë para datës së zgjedhjeve, për listën e kandidatëve, për deputet, për kryetar bashkie dhe për këshillat vendorë, paraqet kërkesën dhe formularin e plotësuar të aplikimit pranë Autoritetit për Informimin

mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në lidhje me ekzistencën për ta, të informacioneve në dokumente të ish-sigurimit të shtetit, për qëllime të transparencës së pastërtisë së figurës.

2. Kandidati i pavarur për deputet, për kryetar bashkie dhe për këshillat vendor, 70 ditë para datës së zgjedhjeve paraqet kërkesë dhe formularin e plotësuar të aplikimit pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në lidhje me ekzistencën për të, të informacioneve në dokumente të ish-sigurimit të shtetit, për qëllime të transparencës së pastërtisë së figurës.

3. Në çdo rast Autoriteti me marrjen njoftim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, lidhur me regjistrimin e listës së kandidatëve 50 ditë përpara ditës së zgjedhjeve që konkurojnë për zgjedhjet e radhës, kryen procesin e verifikimit dhe përgjigjet në përputhje me përcaktimet e nenit 26 dhe 30, të ligjit nr. 44/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Populllore Socialiste të Shqiqërisë", të ndryshuar, duke informuar subjektin që ka bërë kërkesën dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

4. Nëse vetëdeklarimi është i rremë në raport me rezultatin e verifikimit, bazuar në parashikimet e nenit 30 të ligjit 45/2015, çështja dërgohet pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili e përcjell më tej në organet përgjegjëse të hetimit për kryerjen e veprimeve përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E

LINDITA NIKOLLA